



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 16 gusht 2021
Nr. ref.:RK 1837/21

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI60/21

Parashtrues

Nehale Lila

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të
Kosovës, Ac.nr.6316/2020, të 26 shkurtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Nehale Lila, nga Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja e kërkesës e konteston Aktvendimin [Ac.nr.6316/2020], të 26 shkurtit 2021, të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) në lidhje me Aktvendimin [PPP. nr. 108/2020], të 26 tetorit 2020, të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtrueses së kërkesës të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) si dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesja e kërkesës gjithashtu ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktvendimin [Ac.nr.6316/2020], të 26 shkurtit 2021, të Gjykatës së Apelit, në ndërlidhje me Aktvendimin [PPP. nr. 108/2020], e 26 tetorit 2020, të Gjykatës Themelore.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 26 mars 2021, parashtruesja e kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 29 mars 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 2 prill 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesen e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ajo që të plotësojë formularin zyrtar për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë.
9. Në po të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës i është dërguar Gjykatës së Apelit lidhur me njoftimin për Aktvendimin e kontestuar.

10. Më 15 qershor 2021, Gjykata kërkoi përsëri nga parashtuesja e kërkesës që të dorëzojë formularin zyrtar të kërkesës, Kontratën për kredinë dhe Marrëveshjen mbi pengun me nr.184278 të 2 qershorit 2017.
11. Më 7 prill 2021, parashtuesja e kërkesës pranoi shkresën e parë të Gjykatës por nuk iu përgjigj kërkesave të saj.
12. Më 17 qershor 2021, parashtuesja e kërkesës pranoi shkresën e dytë të Gjykatës por përsëri nuk iu përgjigj kërkesave të saj.
13. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21 të Gjykatës, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
14. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 28 korrik 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve

17. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se, më 2 qershor 2017, parashtuesja e kërkesës, në cilësinë bashkë-kredimarrëse me bashkëshortin e saj të ndjerë F.L., kishin nënshkruar Kontratën e kredisë [Nr.184278] me institucionin bankar "TEB Sh.A." (në tekstin e mëtejme: kreditori). Nga po të njëjtat shkresa, rezulton që borxhi ndaj institucionit bankar ishte transferuar tek parashtuesja e kërkesës në cilësinë e bashkë kredi-marrëses pas vdekjes së bashkëshortit të saj F.L.
18. Më 12 qershor 2020, kreditori kishte paraqitur propozimin për përmbarim duke u thirrur në Kontratën për kredinë [nr.184278] të 2 qershorit 2017 dhe Marrëveshjen mbi pengun.
19. Më 12 qershor 2020, përmbaruesi privat përmes Urdhrit për përmbarim [P.nr.178/20] paraqiti propozimin për përmbarim duke kërkuar nga

parashtruesja e kërkesës, në cilësinë e debitorit që të përmbushet borxhi në vlerë prej 10.463.93 euro.

20. Më 17 qershor 2020, parashtruesja e kërkesës kundër Urdhrit për përmbarim [P.nr.178/20], të 12 qershorit 2020 paraqiti prapësim në Gjykatën Themelore me pretendimin për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në prapësimin e saj, parashtruesja e kërkesës theksoi se debitor në këtë rast ishte, F.L., bashkëshorti i saj i cili kishte ndërruar jetë. Parashtruesja e kërkesës gjatë kësaj procedurës po ashtu pohoi se në rastin konkret kanë ndodhur ndryshime të rrethanave dhe si rezultat i kësaj duhet të aplikohet klauzola "*rebus sic stantibus*" dhe në fund kërkoi që të anulohet përmbarimi deri në ndarjen e trashëgimisë.
21. Në po të njëjtën datë, kreditori paraqiti në Gjykatën Themelore përgjigje në prapësim dhe theksoi se "*prapësimi i debitorit nuk është i bazuar në asnjërin nga paragrafët 71 [të LPP-së] dhe si i tillë nuk ka bazë ligjore. Sa i përket pretendimeve të Debitorit se ka vdekur kredi marrësi, kjo do të rezultojë me kërkesën për caktimin e përfaqësuesit të përkohshme konform dispozitave të ligjeve të aplikueshme në Kosove dhe nuk e liron bashkë kredi-marrësen nga përgjegjësia e pagesës se kredisë*".
22. Gjykata Themelore, në bazë të kërkesës se kreditorit, e kishte caktuar parashtruesen e kërkesës përfaqësuese të përkohshme për bashkëshortin e saj të ndjerë.
23. Më 26 tetor 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [PPP. nr. 108/2020] refuzoi prapësimin e parashtrueses së kërkesës lidhur me pagesën e borxhit në shumën prej 10,463.93 euro. Vendimin e saj, Gjykata Themelore e bazoi në nenin 21, 22, 71 dhe 73 të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (në tekstin e mëtejme: LPP) me arsyetimin se: (i) dokumenti në bazë të cilit është lejuar përmbarimi ka titull ekzekutiv dhe ka tipare të përmbarueshmërisë; dhe (ii) gjeti se pretendimet e prapësimit nuk hyjnë në shkaqet e tjera të nenit 71 të LPP-së, të cilat po që se ekzistojnë mund të pengojnë përmbarimin e lejuar.
24. Kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe shkelje esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore. Në ankesën e saj, parashtruesja e kërkesës arsyetoi se nuk ishte palë kontraktuese si kredi-marrëse apo si garantuese e kredisë dhe se në bazë të nenit 85 të LPP-së nga përmbarimi përjashtohen të hollat e gatshme të debitorit i cili ka të hyra mujore të përhershme deri në shumën mujore që sipas ligjit përjashtohet nga përmbarimi e proporcionalisht me afatin kohor deri në pagesën e ardhshme.
25. Më 26 shkurt 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [Ac.nr.6316/2020] në kuptim të neneve 77 dhe 17 të LPP-së në lidhje me nenin 209, pika b) të LPK-së refuzoi ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazuar.
26. Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit të saj të lartcekur arsyetoi se Aktvendimi i Gjykatës Themelore nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht nuk është në kundërshtim me

paragrafin 1 dhe 2 të nenit 182 të LPK-së. Ndër të tjera, Gjykata e Apelit vlerësoi se në rastin e parashtrueses së kërkesës është proceduar propozimi për ekzekutim në bazë të dokumentit përmbarues duke u bazuar në nenin 21 dhe 22 të LPP-së.

Pretendimet e parashtrueses së kërkesës

27. Në kërkesën e saj, parashtruesja e kërkesës pretendon se përmes Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit i janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta e për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe nenet 6 [E drejta për një proces të rregullt], 13 (E drejta për zgjidhje efektive) dhe neni 1 (Mbrojtja e pronës) të protokollit 1 të KEDNJ-së.
28. Parashtruesja e kërkesës thekson se: *“Unë nuk kam marrë kredi, po kredinë e ka marrë bashkëshortin im tani i ndjeri [...]. Unë jetoj në kushte shumë të vështira ekonomike. Pse Gjykata pa me ftuar mua me ka caktuar përfaqësuese e përkohshme e tani të ndjerit [...]. Nuk dëshiroj që të jem përfaqësuese e përkohshme e tani të ndjerit [...].”*
29. Në fund, parashtruesja e kërkesës kërkon nga Gjykata që të anulojë aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit.

Kërkesa për masën e përkohshme

30. Parashtruesja e kërkesës shprehimisht kërkon vendosjen e masës së përkohshme ndaj Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit me arsyetimin që *“mos të i mundësohet kreditorit që të realizon qëllimin e vet në mënyrë kundërligjore duke marrë të hollat tona në mënyrë të kundërligjshme”*.

Vlerësimi i pranueshmerisë së kërkesës

33. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
34. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet nenit 113.1 dhe 7 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

Neni 113

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

35. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale] dhe 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

36. Në vlerësimin nëse parashtruesja e kërkesës i plotëson kërkesat kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së saj, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatë shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore nga një autoritet publik, pasi i kanë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. I njëjti kusht përcaktohet edhe në nenin 47 të Ligjit.
37. Përveç kësaj, neni 48 i Ligjit posaçërisht i obligon parashtruesit e kërkesave të theksojnë qartë aktin konkret të autoritetit publik të cilin ata e kontestojnë. I njëjti nen gjithashtu i obligon parashtruesit e kërkesave të tregojnë qartë se cilat të drejta dhe liri ata pretendojnë se u janë shkelur.
38. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Nëse kërkesa [...] nuk është [...] e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të [...] plotësuar kërkesën [...]”

39. Gjykata më tej i referohet rregullit 32 (2) (h) [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

*(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:
[...]*

*(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.
[...]*

40. Gjithashtu në lidhje me këtë, Gjykata më tej i referohet rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së punës, i cili përcakton:

[...]

(5) Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën, nëse kërkesa është përsëritje e një kërkesë të mëparshme të vendosur nga Gjykata, ose në qoftë se kërkesa është joserioze.”

41. Gjykata rikujton se kërkesën e parashtgueses së kërkesës e kishte pranuar me 26 mars 2021. Duke marrë parasysh që kërkesa nuk ishte e kompletuar, me 2 prill 2021, ne pajtim me paragrafin 4 të nenit 22 (Procedimi i kërkesës) të Ligjit dhe pikat (f) dhe (g) të paragrafit (2) të rregullit 32 (Parashtimi i kërkesave dhe i përgjigjeve) të Rregullores së punës, Gjykata i kërkoi parashtgueses së kërkesës, që të plotësojë kërkesën e saj, përkatësisht, formularin zyrtar të kërkesës në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi të shkresës së parë. Gjykata verën se më 7 prill 2021, parashtguesja e kërkesës pranoi shkresën e parë të Gjykatës për plotësim të formularit por nuk iu përgjigj kërkesave të saj. Për pasojë, më 15 qershor 2021, Gjykata iu drejtua serish parashtgueses së kërkesës me një kërkesë që të dorëzojë formularin zyrtar të kërkesës, Kontratën për kreditë dhe Marrëveshjen mbi pengun me nr.184278 të 2 qershorit 2017 në afat prej 10 (dhjetë) ditësh. Gjykata verën se më 17 qershor 2021, parashtguesja e kërkesës pranoi shkresën e dytë të Gjykatës por përsëri nuk iu përgjigj kërkesave të saj.
42. Në këtë aspekt, Gjykata i referohet paragrafit (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës, i cili përcakton si në vijim:

*Rregulli 35
(Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës)*

[...]

“(5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën,”.

[...]

43. Gjykata thekson se rregulli i lartcekur i Rregullores së punës, i mundëson Gjykatës që të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër nëse, ndër të tjera, kërkesa e një parashtguesi të kërkesës është e paplotë dhe e paqartë, përkundër kërkesave të Gjykatës për të plotësuar dhe qartësuar kërkesën përkatëse. Gjykata i është drejtuar parashtgueses së kërkesës dy herë me një kërkesë të tillë, pa sukses.
44. Gjykata rithekson se në rrethanat e rastit konkret, kërkesa është e paplotë në kuptim të mos plotësimit të formularit zyrtar të Gjykatës me informatat e duhura dhe dorëzimit të dokumenteve mbështetëse të kërkuara nga Gjykata me shkresën e 15 qershorit 2021.
45. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtgueses së kërkesës, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejme, për shkak se është e

paplotë dhe e paqartë, siç është përcaktuar në paragrafin (5) të rregullit 35 të Rregullores së punës.

46. Gjkata rikujton se barra për të ndërtuar, sqaruar dhe plotësuar kërkesën bie mbi parashtruesit e kërkesave, të cilët kanë interes të drejtpërdrejtë në mënyrë që pohimet dhe pretendimet e tyre të adresohen në mënyrë efektive nga Gjykata. Në rastet kur parashtruesit e kërkesave nuk i përgjigjen kërkesave të Gjykatës për qartësimin dhe plotësimin e kërkesës, Gjykata, i refuzon këto kërkesa me procedurë të shkurtër (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI48/17, me parashtruese *Slađana Radojković-Marinković*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 21; dhe KI74/18, me parashtrues *Gëzim Murati*, Vendim për refuzimin e kërkesës, i 3 dhjetorit 2018, paragrafi 26).
47. Përfundimisht, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 22, 47 e 48 të Ligjit dhe rregullin 35 (5) të Rregullores së punës, më 28 korrik 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani